

VENDIM
Nr.48, datë 30.1.1997

PËR PËRDORIMIN E PROKURIMIT TË DREJTPËRDREJTË PËR FURNIZIMIN ME
SHTYPSHKRIME DHE ARTIKUJ KARTOLERIE

Në mbështetje të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, neni 17 pika 3, me propozimin e Kryetarit të Këshillit të Ministrave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kontraktimi e prodhimi i librezave të kursimit dhe i dokumentacionit shoqërues, që do të përdoret për shpërndarjen e fondeve të ngrira të fondacioneve, si dhe furnizimi me artikuj kartolerie të nevojshëm për këtë veprimtari, të bëhet me prokurim të drejtpërdrejtë:

- Për Bankën e Kursimeve me:

a) shtypshkronjën “Dukagjini”- Pejë për prodhimin e 100 000 copë librezave të kursimit me shumën e përgjithshme 130 000 DEM;

b) shtypshkronjën “At Gjergj Fishta” për prodhimin e 200 000 copë kartela depozituesish me shumën e përgjithshme 990 000 lekë.

c) shtypshkronjën “Edlor” për prodhimin e 2000 copë blloqe ditare arkëtimi dhe 2000 copë blloqe ditare pagese me shumën e përgjithshme 240 000 lekë;

ç) shtypshkronjën “Cetis” Slloveni për prodhimin e 200 000 copë mandatpagesave, 200 000 copë mandatar këtëmeve të jashtme dhe 200 000 copë mandatar këtëmeve të brendshme me shumën e përgjithshme 33 800 DEM;

d) firmën “Infosoft” për furnizimin me artikuj kartolerie me shumën e përgjithshme 1 000 000 lekë.

- Për Bankën Kombëtare Tregtare me:

a) shtypshkronjën “Morava” për prodhimin e 100 mijë librezave të kursimit me vleftë 70 mijë USD;

b) shtypshkronjën “Morava” për prodhimin e 100 mijë copë kartela depozituesish me vleftë 10 mijë USD;

c) për sportele të përkohshme me vleftë 990 000 lekë;

ç) për banakë dhe pajisje me vleftë 4 420 000 lekë.

2. Ngarkohen Banka e Kursimeve dhe Banka Kombëtare Tregtare për kontraktimin dhe furnizimin me shtypshkrime e artikuj kartolerie me firmat e sipërpërmendura.

3. Shpenzimet për të gjitha llojet e shtypshkrimeve dhe artikujt e kartolerisë përballohen nga fondet e Bankës së Kursimeve dhe të Bankës Kombëtare Tregtare.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi